



**BASHKIA  
TIRANË**

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK**

**V E N D I M**

**Nr.65, datë 12.06.2020**

**“PËR  
DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR FAMILJET QË KANË PËSUAR DËME  
NDËRTIMORE DHE ORENDIVE/PAJISJE ELEKTROSHTËPIAKE SI PASOJË E  
FATKEQËSIVE NATYRORE”**

Në mbështetje të nenit 113, pika 2, të Kushtetutës, nenit 8, pika 2, nenit 9, pika 1, nënpika 1.1, shkronja “b”, nenit 29, pika 1, nenit 55, pikat 2 dhe 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar, Ligjit nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, kreut III, pika 1, shkronja “ë”, të Vendimit nr. 329, datë 16.05.2012, të Këshillit të Ministrave “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

**V E N D O S I :**

1. Të akordojë ndihmën financiare prej 4, 346, 144 (katër milion e treqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e dyzet e katër) lekë për 12 (dymbëdhjetë) familje që kanë pësuar dëme ndërtimore dhe orendive/pajisje elektroshtëpiake, si pasojë e zjarrit, përmbytjes dhe tërmetit, sipas listës bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse të këtij vendimi.
2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i pikës 1, të këtij vendimi, të përballohen nga fondi i emergjencave i parashikuar në Programin e Mbrojtjes nga zjarri dhe mbrojtja civile (Kod Programi 03280) të aparatit të bashkisë në artikullin 606 në buxhetin e vitit 2020 të Bashkisë së Tiranës.
3. Ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e Menaxhimit Financiar për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të Ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, të ndryshuar.

**K R Y E T A R I**

**TONI GOGU**

**Lista emërore e familjeve që përfitojnë dëmshpërblim financiar:**

<b>NR.</b>	<b>EMËR</b>	<b>MBIEMËR</b>	<b>SHUMA</b>
<b>1</b>	Tahir	Firi	1,348,746.00
<b>2</b>	Sali	Rexha	168,790.00
<b>3</b>	Rasim	Xheli	261,910.00
<b>4</b>	Hatixhe	Karkanaqe	203,927.00
<b>5</b>	Alma	Hamza	349,200.00
<b>6</b>	Barjam	Metaj	106,715.00
<b>7</b>	Lule	Hoxha	435,384.00
<b>8</b>	Lutfije	Kaziu	147,600.00
<b>9</b>	Nok	Marena	243,683.00
<b>10</b>	Albert	Shkodra	594,887.50
<b>11</b>	Pashk	Seferi	257,400.00
<b>12</b>	Ali	Mali	227,901.50
	<b>SHUMA TOTALE</b>		<b>4,346,144.00</b>